



A K T T H E M E L I M I

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SHPIRAGU" sh.p.k. e perfaqesuar nga ortaket themelues SHERIF KAPLLANI dhe AGRON LLESHI, eshte person juridik me Seli qender ne Tirane, Rruga "Luigj Gurakuqi" Nr.111.

Neni 1

Ortaket vendosen te themelijne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "SHPIRAGU" sh.p.k. me seli ne qytetin e Tirane, Rruga "Luigj Gurakuqi" Nr.111.

Neni 2

Shoqeria "SHPIRAGU" sh.p.k. eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet me ligj sipas legjislacionit ne fuqi. Aktit te themelimit dhe Statutit.

Neni 3

Shoqeria "SHPIRAGU" sh.p.k. do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe 10 vjet.

Neni 4

Objekt I shoqerise "SHPIRAGU" sh.p.k. eshte :

* Tregeti me shumice dhe pakice si dhe import - eksport te artikujve industriale ,elektroshtepiak ,ushqimore,pjese kembimi te ndryshme ,lende te para, dhe tregetim me shumice e pakice dhe import - eksport te medicinaleve dhe etervajore.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore ,shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje cdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj.

Neni 5

Kapitali themeltar I shoqerise "SHPIRAGU" sh.p.k eshte 100.000 "njqind mije)leke

Neni 6

Rregullat e shoqerise jane pershkruar ne statutin e bashkangjitur kesaj kontrate.

Neni 7

Administratore te shoqerise "SHPIRAGU" sh.p.k. do te jene SHERIF KAPLLANI dhe AGRON LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

[Signature]
Nr. 797 REP
LR 189 KOL

V E R T E T I M

Sot ne Tirane me date 19.02-1998,para meje noteras u paraqiten personalisht Agron Lleshi e Sherif Kapllani, machor, ma zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga lternjoftimet personale me nr e siperpermendur te cilet deklaruan se kontraten e siperme e kane per' piluar me vullnet te tyre te lire e te plote, dhe e vertetojne edhe me nensh krimet e tyre para meje te cilat une ne bazat e ligjit i vretetoj.

PULE TAKSE





STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Personat qe firmosin me poshte :

SHERIF KAPLLANI I biri I Caushit ,I datelindjes 1963,lindur ne Berat ,me banim ne Tirane ,Ruga "Zonja Curre "Nr.92/1 identifikuar me Pasaporten

AGRON LLESHI I datelindjes 1967 ,lindur ne Tirane dhe me banim ne Tirane Ruga "Luigj Gurakuqi " Nr.111 Tirane identifikuar me Pasaporten 0631938.

Kane hartuar si me poshte vijon Statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te cilen ne baze te Kontrates se Themelimit kane vendosur ta themelojne:

KREU I

FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,SELIA,KOHEZGJATJA

Neni 1

Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne menyre te vecante me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare " dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise si dhe me dispozitat e ketij Statuti.

Neni 2

Emertimi I shoqerise eshte "**SHPIRAGU " SH.P.K**

Neni 3

Shoqeria do te kete objekt te veprimtarise se saj :

* Tregeti me shumice dhe pakice si dhe import - eksport te artikujve industriale ,elektroshtepiak ,ushqimore,pjese kembimi te ndryshme ,lende te para, dhe tregetim me shumice e pakice dhe import - eksport te medicinaleve dhe etervajore.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore ,shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe te kryeje cdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj.

Neni 4

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ,Ruga "Luigj Gurakuqi " Nr.111 Transferimi I shoqerise behet me miratimin unanim te ortakeve.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Neni 6

Shoqeria ka vulen e saj ne formen e percaktuar nga ortaket.



KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Neni 7

Kapitali themeltar do te jete 100.000 (njqindmije) leke.
Kapitali themeltar eshte I ndare ne 100 pjese plotesisht te shlyera me vlere 1000 leke secila te renditura sipas numrit te serie nga 1 deri ne 100.

Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve depozitohen ne nje nga bankat e Tiranes nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SHPIRAGU" SH.P.K para fillimit te aktivitetit.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet pjeseve te reja ortaket kane te drejten e perparesis se nenshkrimin proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi I kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakeve. Zvogelimi I kapitalit prek te gjitha ortaket ne te njejten mase.

Neni 8

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhtme :

1. **SHERIF KAPLLANI** 50.000 leke (pesedhjet mije) ose 50 %
2. **AGRON LLESHI** 50.000 leke (pesedhjet mije) ose 50 %

Ne te drejtat dhe detyrimet ortaket jane te barabarte.

Administratore te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SHPIRAGU" SH.P.K., do te jene z.SHERIF KAPLLANI dhe z.AGRON LLESHI

Neni 9

Ne baze te kontributeve te mesiperme :

z. SHERIF KAPLLANI disponon 50 pjese te kapitalit themeltar te renditura ga numri 1 deri ne 50.

Z.AGRON LLESHI disponon 50 pjese te kapitalit themeltar te renditura ga numri 51 deri ne 100.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar nenshkruhen plotesisht dhe pastaj shperndahen ndermjet ortakeve sipas ndarjet se mesiperme .

Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve ,ne rruge trashegimie.

Pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne 4/5 e pjeseve dhe jo ne kushte me te favorshme se ato me te cilat I jane ofruar me pare ortakeve te tjere.

Shkruar

Atlet



KREU III MARRJA E VENDIMEVE DHE KONTROLLI I SHOQERISE ADMINISTRIMI

Neni 11

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese vete ose nepermjet perfaqesuesit te tij dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar,nga ekspertet kontabel te autorizuar,po qe se ka te tille, ose nga likujduesi.

Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje te tilla si :
emerimin ose shkarkimin e administratosreve ,eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve,miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit ,miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit,etj.

Asambleja e zakonshme vendos per ceshtje te tilla si : ndryshime te Statutit,zvogelim I kapitalit themeltar ,transferimin e kapitalit themeltar tek te tretet zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likujdimin e saj.,shnderrimin e shoqerise nga SH.P.K. ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare.

Neni 12

Ne rast nevojje ose kur e tepron ligji ,kontrolli I shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel I autorizuar,i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje.

Shkarkimi I ekspertit kontabel te autorizuar ashtu si dhe emerimi I tij vendoset me votimin e Asamblese ,kur verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU IV VITI FINANCIAR ,LLOGARITE VJETORE ,NDARJA E FITIMEVE

Neni 13

Viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise dhe mbaron me 31 dhjetor 1998.

Cdo vit tjeter financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Llogarite vjetore ,iventari raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe rapoirtet e vecanta te hartuara nga eksperti kontabel I autorizuar ,miratohen nga Asambleja.

Miratimi I bilancit vjetor behet brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

Neni 14

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve ,Asambleja percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividendeve mbi fitimin.

flk

Agnes Heli



Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjeset e kapitalit perbehet nga fitimi I vitit financiar te cilit I jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 se kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter te jene zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga viti I meparshem.

KREU V ZGJATJA E AFATIT ,PRISHJA ,LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 15

Zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise vendoset nga Asambleja.

Neni 16

Shoqeria mund te prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne kete statut ,me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit sipas nenit 15 ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsytet e parashikuara ne ligj.

Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton ,behet I paaftë ose vdes.

Neni 17

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone nje ose disa likujdues ,te cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te saj, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit Asambleja vendos mbi bilancin perfundimtar financiar,mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates ,likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset e tyre ne kapitalin themeltar.

KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 18'

Shnderrimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare kryhet me vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 19

Punesimi I punonjesve ne shoqeri do te behet mbi bazen e Kontrates Kolektive te Punes.Ne Kontraten Kolektive te Punes rregullohen keto ceshtje :

- * kushtet dhe menyra e maredhenies se punes;
- * fillimi I punes

shk.

Ap. Neri



- * koha e punes;mbrojtja ne pune
- * te drejtat dhe detyrimet ne pune
- * paga e punes ,shperblimi etj
- * pushimi I maredhenies se punes

Neni 20

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakeve ose ndermjet shoqerise dhe ortakeve gjate ekzistences se shoqerise osegjate periudhes se likujdimit ,do te zgjidhen me mirekuptim ndermjet tyre dhe kur mirekutimi nuk arrihet organi kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 21

Ky Statut eshte hartuar ne Tirane me19.2.....1998 , ne kater ekzemplare origjinal duke patur fuqi te barabarte ligjore.

O R T A K E T

“SHPIRAGU “ SH.P.K

SHERIF KAPLLANI

AGRON LLESHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
TIRANE

Nr.....796.....Rep
Nr.....198.....Kol

V E R T E T I M

Sot me date 19.02.....1998 (nentedhjet e tete) ne Zyren e Noterise Tirane u paraqiten personalisht para meje ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“SHPIRAGU “ SH.P.K

SHERIF KAPLLANI dhe AGRON LLESHI

te panjohur prej meje me identitetet e mesiperme ,te cilet me deklaruan se Statuti I mesiperm eshte perpiluar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe une Noterja e vertetova ate ne baze te ligjit.



NOTERE

Adelina NINI